



## **Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë**

Në pajtim me nenin 47, paragrafi (1), pika 4) nga Ligji i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10) dhe nenin 103, paragrafi (1) nga Ligji i Bankave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 67/07, 90/09 dhe 67/10), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë, miratoi

### **VENDIM për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për Planin kontabël të bankave**

I. Në shtojcën 1 të Vendimit për Planin kontabël për bankat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 81/11) bëhen këto ndryshime dhe plotësime:

1. Pas llogarisë 0089, shtohen llogaritë e mëposhtme:

"009 Mjete jomateriale të gatshme 0091  
Çmimi i blerjes  
0098 Dëmtim"

2. Pas llogarisë 3117, llogaritë 31070 dhe 31079 ndryshohen si vijon:

"31170 Llogari rrjedhëse të kufizuara në valutë të huaj te bankat vendase  
31179 Korrigjim i vlerës së llogarive rrjedhëse të kufizuara në valutë të huaj  
te bankat vendase

3. Pas llogarisë 64901, shtohet llogaria e mëposhtme:

"649017 Efekti i diferencave të kursit të këmbimit në rezervën speciale për ekspozimin jashtë bilancit"

4. Pas llogarisë 64911, shtohet llogaria e mëposhtme:

"649117 Efekti i diferencave të kursit të këmbimit në rezervën speciale për ekspozimin jashtë bilancit".

II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë

**V.nr. 02-15/X-4/2011**  
**27.10.2011**  
**Shkup**

**Guvernatori  
dhe kryesuesi  
i Këshillit të Bankës Popullore të  
Republikës së Maqedonisë**  
**Димитар Богов**